

VENDIM
Nr.327, datë 29.4.2011

**PËR KALIMIN NË FOND BANESASH TË ISH-OBJEKTEVE TË DALA NGA
RISTRUKTURIMI I MINISTRISË SË BRENDSHME (REPARTI USHTARAK NR.5715),
TIRANË, ME QËLLIM PRIVATIZIMI, NË EMËR TË BANORËVE, NGA ENTI
KOMBËTAR I BANESAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, 11 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”, si dhe të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objektet e repartit ushtarak nr.5715, sipas gentplanit bashkëlidhur, të ndodhur në “Kodrën e Priftit”, Tiranë, miratuar me vendimin nr.255, datë 3.9.1994 të Ministrit të Rendit Publik, si objekte të lira nga rristrukturimi, kalojnë në fond banesash për Entin Kombëtar të Banesave.

2. Pas kalimit të këtyre objekteve në fond banesash dhe regjistrimit të tyre në ZVRPP-në e Tiranës, Enti Kombëtar i Banesave ngarkohet të lidhë kontratat e privatizimit me banorët e pastrehë, të përcaktuar në listat emërore të familjeve, që i bashkëlidhen këtij vendimi, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit (Enti Kombëtar i Banesave) dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha